



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më 02.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 19 dhe 25 mars
2. Miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018
3. Seancë dëgjimore me kandidatin, zotin Deniz Deralla, propozim i Bankës së Shqipërisë, për emërimin e një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
4. Vijimi i diskutimeve për seancën dëgjimore me kandidaturat për postin e kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Ilir Xhakolli, Vullnet Sinaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Pjerin Ndreu, Sadi Vorpsi dhe Dritan Bici

Mungojnë:

Evis Kushi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati dhe Senida Mesi

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Sot në rendin e ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 19 dhe 25 mars; miratimin e projektrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018; seancë dëgjimore me kandidatin, zotin Deniz Deralla, propozim i Bankës së

Shqipërisë, për emërimin e një anëtarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare; vijimi i diskutimeve për seancën dëgjimore me kandidaturat për postin e kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, gjë që e mbaruam si pikë që në momentin që filluam mbledhjen. A ka komente dhe pyetje për procesverbalet e datave 19 dhe 25 mars? Nuk ka.

Miratojen procesverbalet e datave 19 dhe 25 mars.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës, miratimi i projektrezolutës për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018. Fjalën e ka relatori.

Roland Xhelilaj – Faleminderit, kryetar!

Kuvendi i Shqipërisë, duke vlerësuar rolin e Autoritetit të Konkurrencës për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg, në zbatim të ligjit nr. 90121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar”, duke njohur bashkëpunimin e këtij Autoriteti me institucionet qendrore dhe ato rregullatore për akte që mund të prekin funksione të konkurrencës dhe tregjet dhe duke konsideruar se mirëfunksionimi i tregjeve kërkon gjithëpërfshirjen e aktorëve dhe faktorëve të tregut për t’i bërë ata konkurrues dhe sa më të hapur, me synim mirëqenien e konsumatorit, vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2018 në drejtim të rritjes së nivelit të bashkëpunimit me organet e administratës shtetërore dhe lidhjes së marrëveshjeve të reja me entet rregullatore në ruajtje të mjedisit konkurrues dhe vendosjes së balancave; shtimit të numrit të hetimeve në tregjet tradicionale dhe veçanërisht në tregjet e reja shumë sensitive për publikun e gjerë; monitorimin në vazhdimësi të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Konkurrencës, organeve të administratës shtetërore dhe enteve rregullatorë sipas tregjeve që ata rregullojnë; realizimin e ekzekutimit të vendimeve të marra nga Komisioni i Konkurrencës gjatë vitit 2018, si dhe vendimeve të marra ndër vite; forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe përmirësimit të nivelit të ekspertizës të stafit për t’iu përshtatur dinamikës së tregjeve në zhvillim dhe plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit ligjor dhe rregullativ në kuadër të përafrimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me atë europian në fushën e konkurrencës dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga plani kombëtar për integrimin europian 2018-2020.

Në këto kushte, Kuvendi kërkon që Autoriteti i Konkurrencës për vitin 2019 të përmirësojë punën në këto drejtime: të monitorojë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018, veçanërisht për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat sjellin deformime të konkurrencës në treg, duke u fokusuar në dëmin apo përfitimin real të konsumatorit publik; të mbikëqyrë me prioritet dhe të dalë me rekomandime konkrete për tregjet me sensitivitet të lartë publik dhe ndikim social që ka tregu bankar, tregu i ushqimeve spitalore, tregu farmaceutik, si dhe sektori i arsimit të lartë publik dhe privat; të nisë rishikimin e ligjit nr. 90121\2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” të ndryshuar” me fokus përputhshmërinë e plotë me legjislacionin e BE-së në fushën e konkurrencës në kuadër të

përgatitjes për anëtarësim në Bashkimin Europian të përshtatur me kushtet e reja të zhvillimit ekonomik të vendit tonë; të kontribuojë në sensibilizimin e mëtejshëm të publikut për rolin e Autoritetit në garantimin e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe njohjen më të saktët të publikut me veprimtarinë e Autoritetit; të vijojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga plani kombëtar i integritetit europian në drejtim të përafrimit të legjislacionit me direktivat europiane në fushën e konkurrencës; të përqendrohet në trajtimin e stafit të Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, sidomos në vlerësimin e procedurave të prokurimit publik për marrëveshjet e ndaluara në oferta; të jetë më proaktiv në vlerësimin e projektligjeve dhe të njoftojë Kuvendin për vendimmarrjen e Komisionit të konkurrencës lidhur me çdo akt ligjor që prek parametrat e konkurrencës në fazat e shqyrtimit të tyre nga komisionet parlamentare përgjegjëse. Gjithashtu, Kuvendi u kërkon organeve ekzekutive të të gjitha niveleve të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës, duke zbatuar detyrimin për të kërkuar paraprakisht vlerësim ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projektakt normativ, që ka si objekt dhe pasojë dhënien e të drejtave ekskluzive ose kufizimesash apo cilësore të konkurrencës në tregje ose sektorë të ndryshëm ekonomikë, veçanërisht për kontratat koncesionare. Për konsultimet e përhershme në procesin e përgatitjes dhe miratimit të akteve ligjore dhe nënligjore të sigurojë një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Xhelilaj!

A ka komente në lidhje me projektrezolutën? Jo, nuk ka.

Unë kam dy komente. Komenti i parë nuk lidhet me projektrezolutën dhe një që lidhet me të.

Komenti që nuk lidhet me projektrezolutën ka të bëjë me komunikimin e komisionit me qeverinë dhe institucionet shtetërore. Gjatë raportimit u tha nga kryetarja se ka pasur komunikim nga ky komision dhe unë kam kërkuar letrat e komunikimit me shkrim dhe nuk kam asnjë letër. Kështu që dua të më konfirmoni ekzistencën e komunikimit me shkrim, sepse kryetarja tha që është komunikuar. Deri nesër dua të kem letrat, me të cilat ky komision ka komunikuar me qeverinë.

E dyta, për sa i përket rezolutës, në pikën e parë, ku thuhet “Kuvendi rekomandon” besoj se jemi të qartë që do të ndryshohet fjala ‘rekomandon’ me fjalën “kërkon”. Në paragrafin e parë, ku thuhet: “të monitorojë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në tregjet e hetuara gjatë vitit 2018, veçanërisht për kontratat koncesionare në fuqi, të cilat sjellin deformime të konkurrencës në treg, duke u fokusuar në dëmin apo përfitimin real të konsumatorit...” Fjala e fundit do të jetë më e fortë për ta detyruar autoritetin të tregojë dhe të kalkulojë dëmet për konsumatorin, pastaj të rekomandojë.

Në fund të faqes së dytë të draftrezolutës kemi një kërkesë të Kuvendit, që ka të bëjë me ndryshimin e strukturës. Nuk jam i qartë nëse duhet të jetë apo jo në rezolutë. Meqë edhe relatori nuk e ka përmendur, do t'i kërkojmë Kuvendit në kohën e duhur të përmirësohet struktura, por s'besoj se duhet të jetë pjesë e rezolutës.

A ka ndonjë koment tjetër?

A biem dakord me ndryshimet që sugjerova për draftrezolutën?

Biem dakord.

E miratojmë në tërësi rezolutën, bashkë me ndryshimet e rekomanduara dhe ia përcjellim seancës në varësi të axhendës së Kuvendit.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.04.2019, ora 10:10

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – Kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

- Seancë dëgjimore me kandidatin, zotin Deniz Deralla, propozim i Bankës së Shqipërisë, për emërimin e një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.
- Vijimi i diskutimeve për seancën dëgjimore me kandidaturat për postin e kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Ilir Xhakolli, Vullnet Sinaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Ismet Beqiraj, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Pjerin Ndreu, Sadi Vorpsi, Dritan Bici.

Mungojnë:

Evis Kushi, Anastas Angjeli, Ervin Bushati, Senida Mesi.

I ftuar:

Deniz Deralla

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Kalojmë në seancën dëgjimore me kandidatin, zotin Deniz Deralla, propozim i Bankës së Shqipërisë, për emërimin e një anëtari të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Urdhëro, Deniz!

Deniz Deralla – Përshëndetje të gjithëve!

Faleminderit për ftesën!

Siç e dini, prej katër vjetësh drejtoj Departamentin e Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë. Gjatë këtyre viteve marrëdhënia e këtij departamenti me AMF-në ka qenë mjaft e ngushtë për një sërë shkaqesh. Siç ju jeni në dijeni, një pjesë e institucioneve që ne mbulojmë,

pra bankat, kryejnë operacione për llogari të AMF-së, licencohen nga AMF-ja dhe sigurisht që herë pas here lind nevoja që të ketë një inspektim të përbashkët të këtyre institucioneve. Këto inspektime janë kryer në vazhdimësi dhe bashkëpunimi me AMF-në ka qenë mjaft i ngushtë. Ndërkohë, është shprehur edhe interesi nga AMF-ja për raste të veçanta, kur ata kërkojnë të dhëna nga regjistri i kredisë, i cili mbulohet nga Departamenti i Mbikëqyrjes dhe vazhdimisht kemi qenë në kontakte me ta për ta bërë procedurën sa më të shpejtë, më fleksible dhe më të thjeshtë për AMF-në.

Një aspekt tjetër i bashkëpunimit, që Departamenti i Mbikëqyrjes ka me AMF-në, është edhe momenti kur institucione të ndryshme paraqesin obligacione, të cilat, së pari, duhet të miratohen nga Banka e Shqipërisë në përputhje me stadin ku janë institucionet financiare dhe me mundësitë që ato kanë për përballimin e këtyre obligacioneve. Më pas sigurisht që miratohet edhe prospekti nga ana e AMF-së. Gjatë këtyre viteve në mbikëqyrje...

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Deniz!

A ka ndonjë pyetje për zotin Deralla? Nuk ka pyetje.

Faleminderit për paraqitjen dhe dokumentet e detajuara që keni paraqitur! Për komisionin jeni një profesionist i njohur, kështu që qëndrimi im personal, por edhe i komisionit është për ta mbështetur kandidaturën e zotit Deniz Deralla për anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Faleminderit!

Deniz Deralla – Faleminderit!

(Dritan Bici ndërhyr pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Është edhe një gjë e mirë, sepse gjeneratat që kanë ardhur nuk janë për luftë, por vetëm për paqe.

Faleminderit, zoti Deralla!

Faleminderit, zoti Tani!

Komisioni ia përcjell seancës kandidaturën e zotit Deralla, me mbështetje të plotë.

Atëherë, kalojmë në votimin e zotit Deniz Deralla.

Kush është dakord që kandidatura e zotit Deniz Deralla të propozohet në seancë për anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare?

Miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Tani do të kalojmë në votimin e katër kandidaturave për vendin e kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, i cili që nga data 12.03.2019 rezulton vakant. Për kujtesë, emrat janë: zoti Bilal Kola, zoti Pajtim Melani, zoti Olsi Çoku dhe zoti Ardit Çollaku. Pra, këto janë kandidaturat.

Fillojmë votimin emër për emër.

Zoti Bilal Kola. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet kandidatura.

Zoti Pajtim Melani. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet kandidatura.

Zoti Olsi Çoku. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet kandidatura.

Zoti Ardit Çollaku. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Rrëzohet kandidatura.

Atëherë të katër kandidaturat janë rrëzuar nga komisioni për mosplotësim të kushteve për pozicionin e kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Kjo do të thotë se ne, në bazë të ligjit, jemi të detyruar të rihapim procedurën për kandidaturat e reja.

Dua t'u kërkoj Shërbimit të Monitorimeve dhe sektorëve përkatës të Kuvendit që sot të bëjnë gati raportin përfundimtar dhe të rihapin procedurën për kandidaturat e reja.

Faleminderit!

Ishte kënaqësi që ishit sot me mua.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve

Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti